

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të Rënda—në trupin gjykues të përberë nga gjyqtari Vehbi Kashtanjeva-kryetar i trupit gjykues, gjyqtarët Hamdi Ibrahimimi dhe Naser Foniqi si anëtarë te trupit gjykues me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Ferinaze Jashari, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.P.për shkak të veprës penale Vrasje në Tentativë nga neni 178 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe Florent Hashimi, për shkak të veprës penale Lëndim të lehtë trupor nga neni 188par.2 lidhur me par.1 pika 4 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë Departamenti per krime të Rënda PP.I.nr.110/2017, të datës 20.07.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencë të prokurorit së shtetit Hivzi Bajraktari, të akuzuarve A.P.dhe F.H.dhe mbrojtësve të tyre av.M.H. dhe av.B.B. sipas autorizimit, me datë 19.03.2018, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A.P., i biri i G., dhe i Gj. e vajzërisë B., i lindur me dt...., në P., jeton në rrugën “H.Z.”...-P., me numër personal ... të dhëna këto të vërtetuar nga dokumenti i letërnjoftimit i lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën mesme, me profesion m., i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar - Shtetas i Republikës së Kosovës.

I akuzuari F.H., i biri i E., dhe i N. e vajzërisë G., i lindur me dt...., në P., jeton në rrugën “I.K.” nr....-P., me numër personal ... të dhëna këto të vërtetuar nga dokumenti i letërnjoftimit i lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën mesme, i pa pune, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar - Shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

SEPSE:

1.I akuzuari A.P.

Me dt. 24.06.2017 , rreth orës 22:45 , në Prishtinë , në lagjen B. i d., në rr. “Q.B.” me dashje ka tentuar ta privon nga jeta të pandehurin F.H.në atë mënyrë për shkak të mosmarrëveshjeve paraprake në mes tyre, lidhur me një vajzë të quajtur L.K. me të cilën i pandehuri F.H.ka qenë në lidhje dashurie, e njëjta gjatë kësaj kohe është shoqëruar edhe me të pandehurin A.P., dhe pasi që e ka kuptuar i pandehuri F.H., për mes dëshmitares L.K., e kanë lënë takimin në mes tyre në vendin e lartë cekur, aty së pari kanë dalë i pandehuri A.P.dhe L.K., dhe për afërsisht pas 5 minutave, ka shkuar edhe i pandehuri F.H., dhe po sa janë takuar i pandehuri F. i ka thënë L. që të qëndron aty ku ishin takuar, ndërsa të pandehurit janë larguar për afërsisht 10 metra, dhe kanë filluar të fjalosen dhe e kanë sulmuar njëri tjetrin fizikisht, ashtu që i pandehuri F.H.me mjet të fortë, me shishe të verës prej qelqi, e godet në kokë në anën e majtë të pandehurin A.P., ndërsa i pandehuri A.P.me armë të ftoftë – thikë e godet tri herë në pjesën e epërme të trupit të pandehurin F.H., me ç’rast këto dëmtime paraqesin hemotoraks traumatik masiv në

anën e djathtë si pasojë e plagëve prerëse e shpuese në anën e djathtë të krahavorit, në regjionin shpatullor të anës së majtë dhe në regjionin lumbal të shpinës, lëndime këto të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe të mbrehtë, e që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore , -

-Me këtë ka kryer veprën penale Vrasja në tentativë nga neni 178 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së .

2. I akuzuari F.H.

Me datë, kohë, vend dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e parë, me dashje për t'ia dëmtuar shëndetin dhe për ti shkaktuar lëndim trupor, me mjet të rrezikshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor dhe dëmtimin e rëndë të shëndetit, me shishe të verës prej qelqi, një litërshe, e godet në kokë në anën e majtë të pandehurin A.P., dhe pastaj njëri tjetrin e sulmojnë fizikisht dhe gjatë sulmit i pandehuri F. e godet me grushta dhe shqelma në pjesët e ndryshme të trupit , me ç'rast të njëjtit i shkakton plagë shqyese e ndrydhëse në anën e majtë të kokës dhe përdredhje në nyjën e shputës së këmbës së majtë, lëndime këto të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbrehtës (jo të mbrehtë), e që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore.

-Me këtë ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par.1 pika 4 të KPRK-së,

Andaj Gjykata konform neneve 3,4,7,34,41,42,43,45, 46, 73,75,76, dhe nenit 248,365,370, të KPPK-së, të akuzuarit i :

G J Y K O N

Të akuzuarin A.P.i caktohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, të cilin dënim, do ta mbaj në afat prej 15 dite nga dita kur aktgjykimi do ta marrë formën e prerë, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e qëndrimit në arrest shtëpiak nga dt. 25.06.2017 e tutje .

Të akuzuarit F.H.i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë) €, të cilën dënim do ta paguaj në 6 (gjashtë) këste brenda një viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit .

Detyrohen të akuzuarit që secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën nga 100 (njëqind) €, si dhe shpenzimet tjera të procedurës sipas llogarisë së gjykatës.

Konfiskohet thika nga i akuzuari A.P. si mjet i kryerjes së veprës penale .

Ndërpritet masa paraqitje në stacionin policor kundër të akuzuarit A.P..

A r s y e t i m

Prokuroria Publike Themelore Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.110/2017, të dt.20.07.2017, kundër të akuzuarve A.P. dhe F.H., për shkak se i akuzuari A.P.ka kryer veprën penale Vrasje në Tentativë nga neni 178 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, ndërsa i akuzuari F.H.për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 4 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.15.01.2018, i akuzuari A.P.në prezencën e mbrojtësit të tij sipas autorizimit av.M.H. e ka pranuar fajësinë për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 178 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së , ndërsa i akuzuari F.H.në shqyrtimin fillestar dhe në shqyrtimet gjyqësore nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Trupi gjykues e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari A.P., për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 178 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, meqenëse pranimi është bërë pasi që i akuzuari mjaftueshëm është konsultuar me mbrojtësin e tij dhe duke i ditur pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajësisë dhe pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitave të nenit 248 të KPPK-së, dhe është mbështetur në provat dhe faktet që gjenden në shkresat e kësaj lëndë, pasi që nuk ka ekzistuar asnjë rrethanë që do ta përjashtonte përgjegjësin penale. Me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, është pajtuar edhe prokurori i shtetit.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare dhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore ka deklaruar se në seancën e sotme të shqyrtimit kryesor në çështjen penale kundër të pandehurve A.P.dhe F.H. në shqyrtimin kryesor pas administrimit të provave dhe dëgjimit tani të të pandehurit F.H.për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par.1.4 të KPRK-së u vërtetua se i pandehuri me dashje ka kryer veprën penale të lartë cekur më lartë. Fakti se i njëjti me dashje e ka kryer këtë vepër penale edhe për kundër rrethanave se në rastin konkret ka mundur ti ik kësaj veprë të cilën e ka kryer të mos acaroj situatën në mes tyre por i njëjti qëllimisht e ka goditur me shishen e verës së qelqit në kokë të pandehurin A.P., gjatë deklarimit të tij i pandehuri F. theksoj se pasi që e ka goditur të pandehurin Artan janë kacafytur në mes veti dhe pastaj e ka larguar Laurën nga aty e ka shtyrë në vend që ky në atë moment të ik nga më e keqja e cila i ka ndodhur do të thotë që i njëjti ka pasur mundësi si në fillim para se të acarohet gjendja e tyre dhe gjatë përlëshjes pas pranimit të goditjes së parë me thikë ka mundur të largohet nga vendi i ngjarjes por i njëjti prapë ka vazhduar që të kacafytet me të pandehurin A. dhe ta rrëzon në tokë, ku në atë moment ka mundur të largohet dhe mos ti pësojë edhe dy goditje tjera me thikë, me çka rezultohet si i njëjti ka dashur ta kryejë veprën penale për të cilën akuzohet, andaj mbesim në tërësi pranë aktakuzës dhe i propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit .

Meqenëse i pandehuri A.P.në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet me çka vërtetohet se i njëjti e ka kryer veprën penale sikurse në aktakuzë mbesim në tërësi pranë aktakuzës dhe i propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit dhe sa i përket rrethanave lehtësuese dhe rënduese ti ketë parasysh gjykata me rastin e caktimit të dënimit.

Mbrojtësi I të akuzuarit A.P.av.M.H. fjalën përfundimtare gjykatës ia ka prezentuar me shkrim në të cilën ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga i akuzuari ngërthen në vete një mori të rrethanave lehtësuese të cilat shkojnë në favorin e të mbrojturit tim sikurse që

janë pendimi i tij i thellë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla apo të ngjashme penale të cilat duhet ti ketë parasysh gjykata me rastin e caktimit të dënimit. I mbrojturi im gjatë procedurës penale ka treguar sinqeritet duke e përshkruar rastin në detaje se si ka ardhur deri te konflikti në mes të akuzuarve dhe ky konflikt është përmbyllur me pasojat të dyanshme. I mbrojturi im A. u sulmua paraprakisht nga i akuzuari F. duke e sulmuar me shishe të qelqit në kokë të mbrojturit tim dhe këto duhet ti merr parasysh gjykata me rastin e matjes së dënimit dhe po ashtu rrethana se asnjëherë më parë i mbrojturi im nuk ka ra në konflikt me ligjin dhe nuk ka qenë i gjykuar dhe ndaj tij nuk është zhvilluar ndonjë procedurë tjetër penale dhe i njëjti është i moshës së re dhe është i respektuar në familjen e tij dhe në rrethin ku jeton. Qëndrimi i të mbrojturit tim në arrest shtëpiak që 7 muaj, të cilën masë e ka respektuar dhe kjo ka ndikuar në risocializimin e tij dhe po ashtu rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe i ka propozuar trupit gjykues që t'ia zbus dënimin nën minimumin e paraparë ligjor.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.H.av.B.B. në fjalën përfundimtare deklaroi: në këtë çështje penale ndaj të mbrojturit tim F.H.mendojmë se aktakuza e prokurorisë nuk qëndron për faktin se nga provat e administruara nga deklarata e dëshmitares L.K. po ashtu edhe nga deklarimi edhe në seancën e sotme të të mbrojturit tim F.H.është vërtetuar se qëllimi i F. nuk ka qenë konflikti me të akuzuarin A.P.por është sqarimi i situatës dhe raportit ndërmjet këtyre tre personave, në ditën kritike dhe në momentin kritik i mbrojturi im F.H.nuk ka pasur mundësi që ti shmanget këtij konflikti për arsye se gjendemi në një situatë ku asnjëherë më parë nuk i ka ndodhur, nxjerrja e thikës nga ana e të akuzuarit A.P.dhe sulmi ndaj tij e ka detyruar që të veprojë në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, për këto arsye i propozojmë gjykatës që F. të lirohet për këtë vepër penale dhe të shpallet i pafajshëm .

I akuzuari F.H.në mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se: ditën kritike shishen e verës e kam pas me veti meqenëse kam pas për të shkuar me ndejt te një shok që emri i tij tani nuk më kujtohet por e quajnë me pseudonimin “Dedo” dhe pasi që jemi takuar me të akuzuarin A.P. unë e kam ftuar të njëjtin poshtë dhe i kam thënë “a e dinë se unë e kam femër L.” ashtu që i njëjti është përgjigjur se çka ka lidhje kjo nëse don ajo unë ta zë të njëjtën dhe derisa kemi qenë duke u shty me fjalë e kam vërejtur se aty te ne ka ardhur tani dëshmitarja L.K. dhe kur është takuar e njëjta i akuzuari A. e ka nxjerrë thikën prej pjesës afër gjurit nga pantallonat dhe unë e kam marrë shishen e verës që e kam pas në anën e djathtë dhe me një shpejtësi e kam goditur në anën e majtë të kokës dhe nga goditja i akuzuari nuk është rrezuar por me thike ka filluar dhe më ka goditur mua njëherë në gjoks në anën e djathtë dhe dy here në shpinë. Në vendin ku jemi të takuar fillimisht kanë ardhur i akuzuari A. dhe L. dhe pastaj unë dhe i kam thënë L. “ti L. prit se unë dua te flas vetëm me A... Unë e kam kërkuar këtë takim me A. me qëllim që ta dijë se a ka pasur ndonjë raport Artani me Laurën. Pasi që i akuzuari Artan më ka mëshuar herën e pare me thikë në gjoks unë jam kacafytur me të njëjtin dhe pasi qe jam kthyer kah Laura i akuzuari A. edhe dy herë më ka mëshuar me thikë në shpinë dhe në toke është rrezuar A. pasi që kemi filluar të kacafytemi.

Sa i përket te akuzuarit A.P.meqenëse i njëjti ka pranuar fajësinë per veprën penale per te cilën akuzohet, gjykata për te njëjtin nuk ka bere administrimin dhe vlerësimin e provave.

Trupi gjykues pas vlerësimit të provave të paraqitura në shqyrtimet gjyqësore në këtë çështje penale dhe atë:

Deklaratën e dëshmitares L.K., konstatimin dhe mendimin e ekspertit mjeko-ligjor lidhur me lëndimet e pësuarra i akuzuari A.P.i dhënë nga Dr.Musa Gashi me dt.14.07.2017, thirrjes për ndihme mjekësore e dt.26.06.2017 për të akuzuarin A.P.dhe raporti mjekësor nga QKUK në Prishtinë për të njëjtin, foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, në bazë të të cilave është vërtetuar se i akuzuari F.H.me dt.24.06.2017 ka ndërmarrë veprimet inkriminuese sikurse që është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe i njëjti me veprimet e tij ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga Neni 188 par 2 lidhur me par 1 pika 4 të KPRKS-së.

Në bazë të deklaratës së dëshmitares L.K. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor është konstatuar se e njëjta ka qenë në lidhje me të akuzuarin F.H.dy vite para se të ndodhë rasti, dhe tani nuk jam në lidhje me të njëjtin. Të akuzuarin A.P.e kam njohur pak kohe para se të ndodhë rasti dhe me të njëjtin kam dal si shok, por Artani ka pas simpati ndaj meje. I akuzuari F. nuk e ka ditur se kam pasur takim me A., por më vonë e ka kuptuar përmes telefonit tim duke i pa mesazhet dhe F. më ka thënë që do të takohet me A., takimi është caktuar në afërsi të banesës sime, në mbrëmje. Kur jemi takuar i akuzuari F. më tha që unë të largohem dhe këta të dy kanë shkuar nën shkallë, unë kam pritur lartë në një distancë prej 10 m, vendi ku janë takuar të akuzuarit ka qenë errësirë, dhe nga pozita ku kam qëndruar unë nuk kam arritur që ti vërej të akuzuarit, por kam dëgjuar se të njëjtit e kanë ngritur zërin dhe unë kam shkuar aty kam dëgjuar duke u fjalosur, dhe kam parë se në njërin dorë A. e ka pasur thikën por nuk e di se në cilën, thikën e kam pa pjesërisht dhe mua nuk më kujtohet se cili prej të akuzuarve e ka marrë veprimin i pari. Kur e ka pasur thikën në dorë i akuzuari Artan dhe ka tentuar për ti rënë të akuzuarit F., i njëjti për tu mbrojtur e ka goditur me shishe të verës në kokë. Unë pastaj jam munduar që ti ndaj por nuk kam mundur, dhe të njëjtin janë kacafytur në mes vete deri sa ka ardhur një person për ti ndarë. Nga deklarata e kësaj dëshmitare konstatohet se i akuzuari F.H.e ka goditur me shishe në kokë të akuzuarin A. duke i shkaktuar lëndime trupore.

Po ashtu nga konstatimi dhe mendimi mjeko-ligjor i përpiluar nga Dr.M.G. me dt.14.07.2017 është konstatuar se në bazë të raportit mjekësor të lëshuar nga QE në QKUK në Prishtinë me numër 84515 e dt.25.06.2017 për të akuzuarin A.P.konstatohet diagnoza: VLC captis reg. Parieto –temporalis I. Sin., distorsio art. T/c I.sin dhe këto dëmtime të përshkruara më lartë paraqesin plagë sikurse që është përshkruar si në pikën 2 të dispozitivit të aktgjykimit dhe si të tilla paraqesin dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin, ndërkaq nga kopja e raportit mjekësor lëshuar nga Klinika e Kirurgjisë Torakale në QKUK me numër 4932 për të akuzuarin F.H.i trajtuar nga data 25.06.2017 deri më 06.07.2017 janë konstatuar më detajisht në pikën 1 të dispozitivit të aktgjykimit dhe të njëjtat paraqesin dëmtime të rënda trupore.

Se i akuzuari F.H.i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të akuzuarit A.P.është konstatuar nga vetë mbrojtja e të akuzuarit F.H..

Me rastin e përcaktimit të dënimit të akuzuarit A.P.Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit mori parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, sjelljet e mira gjatë seancës gjyqësore dhe pendimin e thellë të shprehur gjatë shqyrtimit gjyqësor në

fjalën përfundimtare si dhe rrethanën se i akuzuari është i moshës relativisht të re dhe në shkresat e lëndës nuk ka prova se i njëjti më parë ka qenë i gjykuar. Për të akuzuarin gjykata nuk gjeti rrethana rënduese. Duke vlerësuar peshën konkrete të veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale ka konstatuar se dënimi i shqiptuar është në harmoni me shkallën e përgjegjëse penale, dhe intensitetin e pasojës së shkaktuar dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-së

Me rastin e caktimit të dënimit të akuzuarit F.H.gjykata pati parasysh rrethanat se i njëjti më parë nuk ka qenë i gjykuar, është i moshës relativisht të re, sjellje të mira gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe për të njëjtin nuk gjeti rrethana rënduese ashtu që dënimi i shqiptuar është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe intensitetin e pasojës së shkaktuar dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-së që ka për qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale nga i akuzuari dhe personat e tjerë.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale dhe paushalli gjyqësor është marre konform nenit 450 par.3 të KPPRK-së

Nga sa u tha me lartë u vendos sikur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr. 235/17, të datës 19.03.2018**

Procesmbajtësja

Kryetari i trupit gjykues-Gjykatësi

Ferinaze Jashari

Vehbi Kashtanjeva

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.